

A janë shqetësuese kamerat kineze që do t'i vëzhgojnë zgjedhjet në Kosovë? **FAQE 4**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KQZ-ja MIRATON PLANIN OPERACIONAL PËR ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT

FAQE 4-5



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar planin operacional për ditën e zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit si dhe votimin e së shtunës të mërgatës në përfaqësisë diplomatike. Kryetari i KQZ-së, Kreshnik

Radoniqi, u bëri thirrje qytetarëve të diasporës që janë regjistruar suksesshëm për të marrë pjesë në zgjedhje, që të votojnë "duke respektuar rendin e shtëpisë në shtetet ku organizohet votimi". Po ashtu, edhe përfaqësues të

institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, nga Policia, Prokuroria e Shtetit, KQZ-ja, KFOR-i, EULEX-i, OSBE-ja dhe përfaqësues të Ambasadës Amerikane e Zyrës së BE-së në Kosovë, janë koordinuar për zgjedhjet e 9 shkurtit

SHENOLL MUHARREMI:
SIPAS TË GJITHA GJASAVE, LV-ja DO TË PËRFUNDOJË NË OPOZITË **F.7**



GRENELLI I KUNDËRPERGJIGJET KURTIT: MARRËDHËNIET SHBA - KOSOVË S'KANË QENË KURRË MË TË DOBËTA **F.7**



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE




TRUMPI VENDOS SANKSIONE NDAJ GJNP-së **F.2**

SORENSENI ZHVILLON BISEDATË NDARA ME BISLIMIN DHE PETKOVIN **F.3**

MBRETËRIA E BASHKUAR EMËRON DIPLOMATEN KAREN PIERCE TË DËRGUAR SPECIALE PËR BALLKANIN PERËNDIMOR **F.7**

EKONOMI



'TREPÇA' RIKTHEN NËN MENAXHIM TË GJITHA PRONAT E VETA **F.8**

ZRRE-ja: ÇDO DEKLARATË PËR RITJEN E TARIFAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE AKTUALISHT ËSHTË E PAVËRTETË **F.8**

SPORT



DRITA DHE BALLKANI E NISIN SEZONIN PRANVEROR ME FITORE **F.8**

Trumpi vendos sanksione ndaj GjNP-së

UASHINGTON, 7 SHKURT - Presidenti amerikan Donald Trump ka nënshkruar një urdhër ekzekutiv duke vendosur sanksione ndaj Gjykatës Ndërkombëtare Penale (GjNP), lidhur me hetimet ndaj Izraelit, aleatit të ngushtë të Shteteve të Bashkuara.

As ShBA-ja e as Izraeli nuk janë anëtarë apo nuk e njohin gjykatën, e cila ka lëshuar fletarrestime për kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu për krimet e pretenduara të luftës lidhur me përgjigjen ushtarake të shtetit të tij në Gazë, pasi Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian - sulmoi Izraelin në tetor të vitit 2023.

Si pasojë e sulmit të Hamasit u vranë afër 1 200 persona dhe u rrëmbyen afër 250 të tjerë, ndërkaq dhjetëra mijëra palestinezë u vranë gjatë

fushatës ushtarake izraelite.

Urdhri i nënshkruar nga Trumpi e akuzon GjNP-në se po përfshihet në “veprime të paligjshme dhe pa bazë që shënjestrojnë Amerikën dhe aleatin tonë të ngushtë Izraelin” dhe për abuzim të pushtetit duke lëshuar “fletarrestime të pabaza” kundër Netanyahu dhe ish-ministrit të tij të Mbrojtjes, Yoav Gallant.

“GjNP-ja nuk ka juridiksion mbi Shtetet e Bashkuara e as Izraelin”, thuhet në urdhër, ku shtohet se gjykata ka vendosur një “precedent të rrezikshëm” me veprimet e saj kundër këtyre dy shteteve.

Nënshkrimi i urdhrin ekzekutiv nga presidenti Trump më 6 shkurt ndodhi teksa Netanyahu po vizitonte Uashingtonin. Ai u takua me Trumpin të martën në Shtëpinë e Bardhë dhe të enjten zhvilloi takime me ligjvënësit në

Kongresin amerikan.

Në urdhër thuhet se ShBA-ja do të vendosë “pasoja të prekshme dhe të rëndësishme” ndaj atyre që janë përgjegjës për shkeljet në GjNP. Veprimet mund të përfshijnë bllokime të pronës dhe asetëve dhe ndalimin e hyrjes në ShBA për zyrtarët e GjNP-së, punonjësit dhe të afërmit e tyre.

As Izraeli dhe as ShBA-ja nuk janë në mesin e 124 shteteve anëtare të Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Një ligj i vitit 2002 autorizonte Pentagonin që të çlironte çdo amerikan apo aleat të ShBA-së që do të mbahej nga gjykata. Më 2020 Trumpi sanksionoi kryeprokuroren e atëhershme në GjNP, Fatou Bensouda, lidhur me vendimin e saj për të hapur një hetim lidhur me krimet e mundshme të luftës të kryera nga të gjitha palët, përfshirë nga



ShBA-ja, në Afganistan.

Megjithatë, sanksionet u hoqën gjatë mandatit të presidentit Joe Biden, dhe ShBA-ja nisi të bashkëpunonte me Gjykatën, veçmas pasi kryeprokurori i ri Karim Khan më 2023 akuzoi presidentin rus Vladimir Putin për krime lufte në Ukrainë.

Ndërkaq, sa iu përket fletarrestimeve të lëshuara ndaj Netanyahu dhe zyrtarëve të tjerë izraelitë, Bideni i kishte cilësuar të turpshme, ndërkaq këshilltari për siguri kombëtare i presidentit Trump, Mike Waltz, e ka akuzuar gjykatën për njëanshmëri.

Kallas: Shkëputja e Baltikut nga rrjeti energjetik rus, fitore për lirinë



BRUKSEL, 7 SHKURT - Shefja për politikë të jashtme e Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, tha se shkëputja e shteteve baltike, Estonisë, Letonisë dhe Lituanisë nga rrjeti i energjisë energjetike i Rosisë, është një “fitore për lirinë”.

Të tri shtetet anëtare të BE-së dhe NATO-s pritet që të shtunën, më 8 shkurt, t'i shkëpusin lidhjet e energjisë elektrike me Moskën, në një lëvizje politike tri dekada pasi këto vende u çliruan nga sundimi i Kremlinit. “Rusia më nuk mund ta përdorë energjinë si mjet për shantazh”, tha Kallas, ish-kryeministre e Estonisë. “Kjo është fitore për lirinë dhe unitetin evropian”.

Shtetet e Baltikut për vite me radhë janë përgatitur që të shkëputen nga rrjeti elektrik i epokës sovjetike dhe të integrohen në rrjetin evropian, por janë përballur me probleme teknologjike dhe financiare.

Shkëputja nga rrjeti energjetik rus u bë më urgjente pasi Rusia nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës më 2022, gjë që nxiti frikë në mesin e shteteve të Baltikut se ata mund të ishin shënjestrat e radhës.

Pas nisjes së pushtimit, ata ndaluan së bleri gaz dhe energji ruse, por rrjetet energjetike të tri shteteve vazhduan të ishin të lidhura me Rusinë dhe Bjellorusinë e të kontrolluara nga

Moska.

BE-ja në përgjithësi ka ulur në mënyrë drastike konsumimin e energjisë ruse, që kur nisi lufta në Ukrainë.

Të shtunën, kur zyrtarisht tri shtetet baltike të shkëputen nga rrjeti rus, pritet të ketë festime zyrtare për këtë ngjarje edhe pse disa konsumatorë janë të shqetësuar se mund të ketë ndërprerje të furnizimit.

Letonia do ta ndërpresë fizikisht linjën elektrike me Rusinë të shtunën dhe presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, do të marrë pjesë në një ceremoni me udhëheqësit e Baltikut që do të mbahet në Lituaninë po atë ditë.

Demokratët zotohen t'i kundërshtojnë ndryshimet në USAID

UASHINGTON, 7 SHKURT - Drejtuesit demokratë në Kongres paralajmëruan presidentin Donald Trump këtë javë se do t'i shfrytëzojnë bisedimet e ardhshme mbi buxhetin federal si një mekanizëm për të ushtruar tryzni, për t'i kundërshtuar ndryshimet e bëra nga administrata për agjencitë qeveritare të Shteteve të Bashkuara si, për shembull, Agjencinë për Zhvillim Ndërkombëtar, USAID, agjencia kryesore që ofron ndihmë humanitare jashtë vendit. Në Uashington, këtë javë, ligjvënësit demokratë protestuan jashtë selisë tashmë të mbyllur të USAID-it dhe jashtë Kongresit.

“Ne do t'i kundërshtojmë shkeljet që ata kanë bërë lidhur me ndarjen e pushteteve. Shkeljen e Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara. Ne nuk do të heshtim. Do të ngrihemi. Do të reagojmë. Do të kundërshtojmë”, tha senatori demokrat Cory Booker.

Më herët gjatë kësaj jave, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar, USAID, u vu nën kontrollin e sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio dhe thaujse të gjithë punonjësit e saj janë dërguar me leje të detyruar, pas një urdhri ekzekutiv të presidentit Donald Trump për ta pezulluar të gjithë ndihmën për vendet e huaja,

ndërsa i nënshtrohet një procesi rishikimi. “Po shohim se si njeriu më i fuqishëm në botë Donald J. Trump dhe njeriu më i pasur në botë Elon Musk po ua heqin paratë dhe ushqimin njerëzve më të varfër në botë”, tha ligjvënësi demokrat Jonathan Jackson.

Ligjvënësit republikanë në Kongres thonë se Trumpi po ushtron autoritetin e gjerë presidencial për t'i rivlerësuar agjencitë federale. Trumpi po e bën këtë përmes miliarderit Elon Musk të cilin e ka vënë në krye të Departamentit të Efikasitetit të Qeverisë, DOGE, që ka si synim shkurtimin e shpenzimeve federale.



Sorenseni zhvillon biseda të ndara me Bislimin dhe Petkoviqin

PRISHTINË, 7 SHKURT - I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Peter Sorensen, tha se ka zhvilluar të enjten biseda ta ndara me kryenegociatorët e të dyja vendeve, për herë të parë prej marrjes së detyrës nga paraardhësi i tij Miroslav Lajçak. Sorenseni shkroi në X: “I vlerësoj bisedat shumë të mira dhe i mirëpres ftesat e tyre për t’i vizituar Kosovën dhe Serbinë”. Ai nuk dha më shumë hollësi rreth bisedave e as rreth vizitave të mundshme në Prishtinë dhe Beograd. Sorenseni, i cili e nisi zyrtarisht punën më 1 shkurt, i zhvilloi këto biseda pak ditë pasi kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, dhe ai i Serbisë, Petar Petkoviç, këmbyen akuza në rrjetet sociale. Bislimi e akuzoi Serbinë për diskriminim dhe urrejtje ndaj shqiptarëve në Luginën e Preshevës, ndërsa Petkoviç e akuzoi kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, se dëshiron që komunitet me shumicë serbe në Kosovë të udhëhiqen nga shqiptarët. Nuk është e qartë se kur mund

ta mbajë takimin e parë Sorenseni në kuadër të dialogut, duke qenë se Kosova do të mbajë zgjedhje më 9 shkurt dhe Serbia përballet me paqartësi politike pas dorëheqjes së kryeministrit. Në takimin e tyre të fundit në Bruksel nën ndërmjetësimin e Lajçakut, më 17 dhjetor, Bislimi dhe Petkoviçi u pajtuan për zbatimin e plotë të deklaratës së përbashkët për personat e zhdukur. Ndërkohë Sorenseni, për dallim nga paraardhësi i tij, do të merret vetëm me dialogun ndërmjet dy vendeve fqinje, e jo edhe me çështje rajonale të Ballkanit. Emërimi i Sorensenit është parë si pozitiv, duke qenë se 57-vjeçari e njëh rajonin. Diplomat prej shumë vitesh, ai ishte angazhuar në Kosovë në kuadër të Misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNMIK), si dhe në role të tjera, në Serbi, Maqedoni të Veriut dhe Bosnjë-Hercegovinë. Sipas njohësve të politikës, ai nuk ka nevojë të informohet paraprakisht për njerëzit apo faktet historike të rajonit, sepse tashmë ka pasur



mundësinë ta krijojë një pasqyrë nga afër. Një tjetër argument që është përmendur si pozitiv nga zyrtarët në Prishtinë është se ai është nga Danimarka, vend që një shtetësinë e Kosovës, dhe se do të ketë qasje të barabartë në dialog. Lajçaki ka qenë në pozitën e ndërmjetësuesit për pesë vjet. Përgjatë mandatit të tij është

arritur Marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve, por nuk është bërë asnjë hap drejt zbatimit të saj. Në të kaluarën, liderë të Kosovës, nisur nga presidentja e vendit, Vjosa Osmani, e deri te kryeministri Albin Kurti, e kanë kritikuar Lajçakun për qasje të pabalancuar në dialog dhe

për rreshtim me raste kah Serbia. Vetë Lajçaku pati thënë në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, muaj më parë, se pretendime të tilla nuk qëndrojnë, dhe pati vlerësuar se shoqëritë në Kosovë dhe Serbi nuk janë të gatshme për normalizim. Kosova dhe Serbia dialogojnë në Bruksel që prej vitit 2011.

Grenelli i kundërpërgjigjet Kurtit: Marrëdhëniet ShBA - Kosovë s’kanë qenë kurrë më të dobëta

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 7 SHKURT - Emisari special i ShBA-së për misionet të veçanta, Richard Grenell, i ka reaguar deklaratës së kryeministrit Albin Kurti, i cili ka thënë se marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Kosovës janë më të forta se kurrë më parë. Në platformën “X”, Grenelli postoi një foto të Kurtit, teksa në mbishkrim të fotos shihet edhe deklarata e tij. Lidhur me këtë, Grenelli thotë se Kurti është iluzionues, teksa shton se me të në krye të qeverisë, marrëdhëniet ShBA - Kosovë kurrë s’kanë qenë më të dobëta. “Iluzionues. Marrëdhëniet nuk kanë qenë

kurrë më të dobëta. Albin Kurti është dënuar nga administrata e parë e Trumpit, administrata e Bidenit, NATO, BE, Ambasada e ShBA-së, Anthony Blinken etj”, ka shkruar Grenelli. Kurti një ditë më parë në një intervistë për “Istogu Chanel” ka thënë se Kosova ka raporte shumë të mira me Amerikën. “Punët kurrë ma mirë nuk i kena pas. Po blejmë helikopterë ‘Black Hawk’ pas blerjes së sistemit ‘Javelin’. Grantin më të madh nga Amerika e kemi marrë gjatë mandatit tonë. Ne kemi bërë avancimin me Amerikën kur raportin me Amerikë nuk e kemi vetëm diplomatik, por e kemi edhe në mbrojtje, në zhvillim dhe në energji”, ka thënë Kurti.

Osmani në ShBA: Me administratën Trump synojmë thellimin e bashkëpunimit

PRISHTINË, 7 SHKURT - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, gjatë qëndrimit në Uashington ka bërë me dije se është takuar me kryetarin e Komisionit të Punëve të Jashtme në Dhomën e Përfaqësuesve. Osmani në “Facebook” ka shkruar se Kosova dhe ShBA-ja kanë një lidhje historike, një aleancë të ndërtuar mbi vlera

të përbashkëta dhe përkushtim për paqe e siguri. “Dje në takim me Brian Mast, Kryetar i Komisionit të Punëve të Jashtme në Dhomën e Përfaqësuesve të ShBA-së, diskutuam për lidhjen historike të Kosovës me Shtetet e Bashkuara - një aleancë e ndërtuar mbi vlera të përbashkëta dhe përkushtim për paqe e siguri. Me

administratën e presidentit Trump, synojmë thellimin e bashkëpunimit në fusha të ndryshme, përfshirë mbrojtjen, investimet strategjike dhe vazhdimin e punës së përbashkët për forcimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës. Mbështetja amerikane ka qenë dhe mbetet jetike për shtetin tonë”, ka shkruar Osmani.



A janë shqetësuese kamerat kineze që do t'i vëzhgojnë zgjedhjet në Kosovë?

Kamera të prodhuara nga një kompani kineze, e cila së voni u sanksionua nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të përdoren në vendvotimet për zgjedhjet e 9 shkurtit në Kosovë. Kompania e Kosovës që furnizoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me to thotë se nuk ka shqetësime të sigurisë për kamerat, të cilat, sipas saj, janë në përputhje me kërkesat e sigurisë të ShBA-së dhe të Kosovës.

PRISHTINË, 7 SHKURT - Zgjedhjet e sivjetme parlamentare në Kosovë do të sjellin një risi sa i përket vëzhgimit të procesit të votimit pasi që, për herë të parë, në qendra votimi do të ketë edhe kamera mbikëqyrëse. Këto kamera u kontraktuan nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në fund të vitit 2024, përmes një procesi tenderues, ku fituese doli kompania "Besa Security", e cila ofertoj me çmimin prej rreth 699 mijë eurosh. Në këtë tender parashihej furnizimi me rreth 2.500 kamera, të cilat do të shërbejnë për t'i vëzhguar vendvotimet dhe për t'i dëshmuar parregullsitë e mundshme gjatë procesit. "Besa Security" i tha "Radios Evropa e Lirë" se, menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, nëntorin e kaluar, kishte bërë porosinë për këto kamera të prodhuara nga kompania kineze "Uniview", për të cilën thotë se është distributore ekskluzive për territorin e Kosovës.

Në lidhje me këto kamera ka pasur raportime të medieve lokale, të cilat, ndër të tjera, ngrënë shqetësime lidhur me sigurinë, për shkak se, që nga dhjetori i vitit 2024, "Uniview" është nën sanksione nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në lidhje me këtë, distributorja nga Kosova thotë se produktet e prodhuara nga "Uniview", veçanërisht ato me të cilat e ka furnizuar KQZ-në, janë në përputhje me Aktin Autorizues të Mbrojtjes Kombëtare (NDAA) të ShBA-së. "Është e rëndësishme të bëhet dallimi midis sanksioneve të vendosura ndaj entiteteve të caktuara dhe kufizimeve që prekin produkte specifike. Produktet [me të cilat kemi] furnizuar [KQZ-në] nuk bien nën asnjë kufizim që do ta pengonte përdorimin e tyre për qëllime civile ose institucionale", thuhet në përgjigjen e "Besa Security"-t për "REL"-in.

NDAA-ja është ligj që përcakton nëse pajisje të caktuara konsiderohen të rrezikshme për

sigurinë kombëtare amerikane. Në listën e ndalesave të NDAA-së bëjnë pjesë disa kompani kineze, përfshirë "Hikvision"-in dhe "Dahua"-n, por deri më tani "Uniview" nuk figuron pjesë e saj.

KQZ-ja nuk u është përgjigjur pyetjeve të "REL"-it në lidhje me kontraktimin e këtyre kamerave. Por, në kushtet e tenderit, KQZ-ja kishte përmendur se kamerat duhet të jenë në përputhje me NDAA-në. Ndërkaq, gjatë prezantimit të planeve për vendosjen e kamerave në vendvotime, KQZ-ja kishte siguruar se kamerat nuk do ta cenonin privatësinë e votimit. "Vendosja e kamerave në vendvotime do të bëhet duke siguruar plotësisht fshehtësinë e votës, pasi ato do të vendosen në skajin tjetër prej ku do të jenë kabinat e votimit, dhe në asnjë rrethanë nuk do të mund ta regjistrojnë shënimin e preferencës nga ana e votuesit", kishte thënë Valmir Elezi, zëdhënës i KQZ-së, në prill të vitit 2024.

Pse u sanksionua kompania kineze nga ShBA-ja?

Sanksionet që u vendosën ndaj "Uniview"-it janë pjesë e një fushate më të gjerë të qeverisë amerikane për t'i goditur me sanksione firmat kineze që prodhojnë teknologji vëzhguese për shkak të "shtypjes ndaj ujgurëve dhe pakicave të tjera myslimane në rajonin perëndimor të Kinës, Shinxhiang". "Roli që qeveria amerikane thotë se 'Uniview' ka pasur është ofrimi dhe, në disa raste, projektimi specifik i pajisjeve dhe softuerëve të mbikëqyrjes, që i lejuan Partisë Komuniste të Kinës t'i identifikonte dhe t'i monitoronte këto grupe etnike", shpjegon Reid Standish, korrespondent i Radios Evropa e Lirë në Pragë, i cili fokusohet në çështjet globale që lidhen me Kinën.

Shtypja e grupeve etnike në Shinxhiang filloi në vitin 2017, dhe mori hov në vitet e



mëvonshme, duke pasur në shënjestër ujgurët dhe grupet e tjera myslimane në Kinën perëndimore, si kazakët etnikë dhe kirgizët. "E gjithë Kina është e mbikëqyrur rëndë dhe mbështetet në kamera dhe programe të ashtuquajturit 'Qyteti i mençur', por gjatë kësaj periudhe Shinxhiangu u bë një nga vendet më të mbikëqyrura në botë", thotë tutje Standish, duke shtuar se fushata [e shtypjes] çoi në krijimin e një sistemi të gjerë kampesh në Shinxhiang, ku njerëz nga këto grupe etnike u mblodhën dhe u vendosën në të ashtuquajturat kampe të 'riedukimit', ku ata u detyruan të mësonin kinezisht, të këndonin këngë patriotike, ta mësonin doktrinën e Partisë Komuniste dhe, në shumë raste, iu nënshtruan shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Standish shton se "Uashingtoni dhe shumë vende perëndimore e kanë cilësuar këtë situatë si shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut, ndërsa disa organizata ndërkombëtare e kanë quajtur madje spastrim etnik". "REL"-i ka raportuar në vazhdimësi në lidhje me sanksionet e ShBA-së ndaj kompanive kineze, përfshirë 'Dahua'-n dhe 'Hikvision'-in, të cilat, po ashtu, prodhojnë kamera vëzhguese.

Një hulumtim i "REL"-it në vitin 2022 gjeti se kamera të sigurisë, të prodhuara nga këto dy kompani, janë të vendosura nëpër shumë institucione të Kosovës, përfshirë ndërtesën e Qeverisë së Kosovës. Autoritetet e Kosovës nuk kanë vënë sanksione për importin e këtyre pajisjeve.

Sa është e sigurt teknologjia kineze e vëzhgimit?

Përtej çështjeve etike që çuan në sanksionet e ShBA-së, sipas Standishit, ka edhe çështje teknike që janë zbuluar me disa prodhues kinezë, të cilat shpesh janë përmendur si arsye për të mos i përdorur ato në ambiente të ndjeshme. "Shqetësimet mbi të dhënat burojnë pjesërisht nga fakti se sistemet e mbikëqyrjes mbështeten në një farë mase në pajisjet dhe softuerët e prodhuesit të kamerave", thotë Standish.

Ai shton se përdoruesit finalë mund t'i vendosin sistemet e tyre të ruajtjes [së të dhënave] dhe të rrjetit, por "të dhënat gjithsesi kalojnë përmes softuerëve të dizajnuar nga prodhuesi, dhe shpesh dërgohen në serverët e

kompanisë në Kinë, përmes resë [kompjuterike]". "Nuk ka asnjë provë apo rast që tregon se këto kamera janë përdorur për ndërhyrje, aq më pak për të ndikuar në një zgjedhje. Por, në një kohë kur integriteti i zgjedhjeve është një çështje e madhe në demokracitë e sotme, dobësitë e markave të ndryshme ngritin mundësinë e ndërhyrjeve të jashtme", thekson Standish. Kompanitë kineze janë furnizueset kryesore të teknologjisë së mbikëqyrjes në botë. Kamerat e tyre janë të lira, të lehta për t'u përdorur dhe për t'u instaluar, dhe ofrojnë performancë të lartë. Kompanitë si "Hikvision" dhe "Dahua" janë pjesërisht në pronësi të shtetit kinez, ndërsa "Uniview" është një kompani private, por ka marrë pjesë në kontrata të qeverisë kineze për t'i mbikëqyrur pakicat në Shinxhiang. Deri më tani ShBA-ja dhe Britania e Madhe kanë vendosur në listë të zezë disa kompani kineze të teknologjisë. Megjithatë, shumica e vendeve evropiane nuk kanë vendosur ndalime të tilla, por kanë zgjedhur t'i heqin kamerat kineze nga përdorimi në institucione qeveritare apo ushtarake.

KQZ-ja miraton planin operacional për zgjedhjet e 9 shkurtit

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar planin operacional për ditën e zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit si dhe votimin e së shtunës të mërgatës në përfaqësisë diplomatike. Kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, u bëri thirrje qytetarëve të diasporës që janë regjistruar suksesshëm për të marrë pjesë në zgjedhje, që të votojnë “duke respektuar rendin e shtëpisë në shtetet ku organizohet votimi”. Po ashtu, edhe përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, nga Policia, Prokuroria e Shtetit, KQZ-ja, KFOR-i, EULEX-i, OSBE-ja dhe përfaqësues të Ambasadës Amerikane e Zyrës së BE-së në Kosovë, janë koordinuar për zgjedhjet e 9 shkurtit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 SHKURT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar planin operacional për ditën e zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit si dhe votimin e së shtunës të mërgatës në përfaqësitë diplomatike.

Qendra e parë diplomatike që do të hapet për votim të mërgatës më 8 shkurt do të jetë në Ankara, ndërsa ato të fundit do të mbyllen janë në ShBA dhe Kanada.

Në kuadër të këtij plani operacional janë paraparë edhe intervalet kohore kur do të bëhet raportimi i daljes së votuesve dhe rezultatet preliminare.

Kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, u bëri thirrje qytetarëve të diasporës që janë regjistruar suksesshëm për të marrë pjesë në zgjedhje, që të votojnë “duke respektuar rendin e shtëpisë në shtetet ku organizohet votimi”. “Është

hera e parë për KQZ-në që e organizojmë votimin për konsullata dhe ambasada. Ftoj qytetarët që janë regjistruar suksesshëm për të votuar të dalin në votim dhe ta respektojnë rendin e shtëpisë në shtetet që organizohet votimi. Uroj për një proces të qetë dhe duke falënderuar stafin e MPJD-së uroj për votim të suksesshëm dhe proces të rregullt dhe demokratik”, tha ai.

Ndërkaq, anëtari i Këshillit për Operacione Zgjedhore në KQZ, Arianit Elshani, ka bërë me dije hollësitë e votimit për zgjedhjet e 9 shkurtit si dhe për votimin e mërgatës më 8 shkurt. “Në kuadër të këtij plani operacional janë paraparë edhe aktorët që do të jenë të përfshirë në dhomën operative të KQZ-së. Bëhet fjalë për prokurorinë dhe Policinë e Kosovës, linjat telefonike që do të jenë të hapura për të raportuar dhe marrë ndonjë informacion nga KQZ-ja në ditën e zgjedhjeve.

Po ashtu, janë ndarë edhe ekipet që do të merren me çështje protokollare, komunikimin dhe informimin. Njëherë janë përcaktuar edhe intervalet kohore se kur do të bëhet raportimi i daljes së votuesëve. Raportimi për pjesëmarrjen në zgjedhje do të bëhet në tre terminë. E para do të bëhet njoftimi për hapjen e vendvotimeve, në orën 11:00 për daljen e votuesve, pastaj dalja e votuesve deri në orën 15:00 dhe në fund në orën 19:00. Pas kësaj mbetet për t’u konfirmuar për rezultatet preliminare. Kohën do ta definojmë gjatë ditës së diel. Të njëjtën raportim do të kemi edhe për ditën e nesërme, për ditën e zgjedhjeve në mërgatë, që do të mbahen në përfaqësitë diplomatike. Qendra e parë e votimit do të jetë ajo në Turqi dhe ajo e fundit që do të mbyllet më e vonshme do të jetë në Amerikë dhe Kanada. Të tjerat janë në time-zonën tonë”, tha ai.

KQZ-ja shqyrtoi edhe një kërkesë për realizimin e një exit-pollit, ku nuk kishte vendimmarrje pasi u konsiderua se për realizimin e tyre jashtë qendrave të votimit nuk ka nevojë për leje.

Krahas këtyre u bë me dije se në ditën e zgjedhjeve, më 9 shkurt, do të jenë edhe 108 ekipe mobile për ta mundësuar votimin për personat me nevoja të veçanta.

Të premten në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës u mbajt takim zyrtar lidhur me planifikimet dhe angazhimin e policisë në zbatimin e planit operativ “Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës”, të cilat do të mbahen më 9 shkurt.

Në këtë takim ka marrë pjesë menaxhmenti i lartë, në krye me drejtorin e përgjithshëm të PK-së, kolonel Gazmend Hoxha, drejtorët e departamenteve si dhe udhëheqës e përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare; nga

Prokuroria e Shtetit, KQZ-ja, KFOR-i, EULEX-i, OSBE-ja dhe përfaqësues të Ambasadës Amerikane e të Zyrës së BE-së në Kosovë.

Të pranishmit janë njoftuar lidhur me planifikimet, vlerësimet dhe angazhimet policore, në ofrimin e sigurisë dhe mbarëvajtjes së procesit zgjedhor, si një proces mjaft i rëndësishëm për vendin.

Drejtori Hoxha gjatë këtij takimi ka theksuar se përmes realizimit të planit operativ duhet të krijohet një ambient i sigurt dhe i qetë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës përmes mbajtjes së rendit, qetësisë dhe sigurisë publike në vend para, gjatë dhe pas procesit të zgjedhjeve.

Përveç të tjerash, ky plan parasheh bashkërendimin e aktiviteteve të përbashkëta të parapara sipas marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të institucioneve kompetente vendore, me qëllim të ofrimit të sigurisë dhe mbarëvajtjes së procesit zgjedhor.

Prokuroria nis hetim pas raportimeve se ambasadori në Kroaci u përfshi në transportimin e votave

PRISHTINË, 7 SHKURT - Prokuroria Themelore në Prishtinë njoftoi të enjten se e ka nisur një hetim pas raportimeve se ambasadori i Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, dyshohet se është përfshirë në transportimin e kundërligjshëm të votave me postë të mërgimtarëve për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë.

“Prokurori i shtetit ka filluar ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme hetimore, nëse në raportimet në fjalë përmbushen elementet e ndonjë veprime penale që lidhet me procesin e zgjedhjeve, me qëllim të ruajtjes së këtij procesi”, tha Prokuroria në një njoftim për medie. Gazeta “InFokus” raportoi



ditën e njëjtë se Berishaj kishte tërhequr zarfe me vota nga posta dhe i kishte dorëzuar ato në Ambasadën e Kosovës në Kroaci, misionin diplomatik që e udhëheq. Zëdhënësi i Komisionit Qendror Zgjedhor, Valmir Elezi, tha për “Radion Evropa

e Lirë” se komisioni është duke vlerësuar nëse tërheqja e pakove është bërë në përputhje me ligjin. “Lidhur me lajmin që po qarkullon për tërheqjen e pakove me fletëvotime nga kutia postare e KQZ-së në Zagreb (Kroaci), sqarojmë se do të vlerësohet

nëse tërheqja e pakove me fletëvotime nga kjo kuti postare është bërë sipas akteve nënligjore dhe KQZ do të marrë vendim meritore”, tha ai.

Sipas KQZ-së, tërheqja e dërgesave postare nga kutitë postare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe dërgimi i materialeve zgjedhore në përfaqësi diplomatike, bëhet përmes rrugëve tokësore nga zyrtarët e KQZ-së, me ndihmën e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD).

Ajo tha se MPJD-ja ka siguruar automjetet transportuese të cilat do të drejtohen nga zyrtarët e saj. MPJD-ja nuk iu përgjigj pyetjeve të “Radios Evropa e Lirë” në lidhje me

hetimin ndaj Berishajt.

Më 9 janar filloi votimi me postë për shtetasit e Kosovës që jetojnë jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare të Kosovës të cilat mbahen më 9 shkurt.

Nga 104 924 votues që janë regjistruar për të votuar jashtë Kosovës, 84 525 prej tyre kanë zgjedhur të votojnë përmes postës, sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Pra, 67 421 janë regjistruar për të dërguar pakon me fletëvotim në kutinë postare të KQZ-së jashtë Kosovës, kurse 17 104 do ta dërgojnë pakon me fletëvotim në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë. Sipas regjistrimit të popullsisë, në diasporë jetojnë rreth 550 mijë kosovarë.

Kushtëzimi i Serbisë me njohjen e Kosovës: Një nevojë gjeopolitike dhe strategjike për Perëndimin



Shkruan: Prof.
Dr. Fejzulla BERISHA

1. Serbia midis Perëndimit dhe Lindjes

Serbia vazhdon të ndjekë një politikë të dyfishtë në arenën ndërkombëtare, duke përfutur nga ndihmat dhe marrëdhëniet me Perëndimin, ndërkohë që thellon bashkëpunimin me Rusinë, Kinën dhe vendet e tjera autoritare. Qasja e saj për të përfutur nga të dyja anët është bërë një pengesë serioze për stabilitetin rajonal, veçanërisht për Kosovën. Në këtë kontekst, është jetike që bashkësia ndërkombëtare ta kushtëzojë Serbinë në çdo aspekt me njohjen e Kosovës. Kjo strategji nuk do të ishte vetëm në interesin e Kosovës, por edhe në interesin strategjik të Perëndimit, për të frenuar ndikimin e fuqive autoritare në Ballkan. Në këtë analizë të zgjeruar do të shqyrtojmë: Pse Serbia nuk është më një partner i besueshëm për Perëndimin? Si e ka përdorur Serbia

mbështetjen e Perëndimit kundër Kosovës? Raste konkrete të sabotimit nga Serbia në krahësim me shtete të tjera që janë kushtëzuar për anëtarësim në BE dhe marrëdhënie ndërkombëtare

Mekanizmat që mund të përdorë Perëndimi për ta detyruar Serbinë ta njohë Kosovën

2. Serbia si partner i pabesueshëm për Perëndimin.

2.1. Refuzimi i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe diplomacia e sabotimit. Serbia ka treguar në mënyrë të përsëritur se nuk respekton marrëveshjet ndërkombëtare. Kjo është e qartë në disa raste: Marrëveshjet e Brukselit (2013, 2015, 2023): Serbia ka nënshkruar disa marrëveshje me Kosovën, por nuk i ka zbatuar ato. Për shembull, marrëveshja për lirinë e lëvizjes dhe njohjen e diplomave është zbatuar vetëm nga Kosova, ndërsa Serbia vazhdon të pengojë qytetarët e Kosovës të lëvizin lirshëm në territorin e saj. Marrëveshja e Ohrit (2023): Edhe pse u arrit një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve, Serbia refuzoi ta nënshkruajë formalisht, duke treguar qartë se nuk ka ndërmend ta zbatojë.

2.2. Rasti i Serbisë krahasuar

me vendet e tjera në rrugën e integritetit në BE.

Ndryshe nga Serbia, vende të tjera që kanë ndjekur rrugën e integritetit evropian janë detyruar të bëjnë lëshime të mëdha për t'u anëtarësuar. Krahësimi i mëposhtëm tregon standardin e dyfishtë që i është lejuar Serbisë: Kroacia. **Kushti për anëtarësim në BE:** Dorëzimi i të gjithë të akuzuarve për krime lufte në Tribunalin e Hagës (p.sh., gjeneral Ante Gotovina). Rezultati: Anëtarësimi në BE (2013)

Maqedonia e Veriut. **Kushti për anëtarësim në BE:** Ndryshimi i emrit për të zgjidhur konfliktin me Greqinë. Rezultati: Marrë hapjen e negociatave për BE (2020).

Mali i Zi. **Kushti për anëtarësim në BE:** Reforma e thellë në sistemin e drejtësisë dhe lufta kundër korrupsionit. Rezultati: Hapja e kapitujve të negociatave për BE.

Serbia. Kushti për anëtarësim në BE: Nuk ka plotësuar asnjë nga kushtet thelbësore, vazhdon të bllokojë Kosovën dhe të mbështesë Rusinë. Rezultati: Vazhdon të marrë fonde nga BE dhe të avancojë në negociata.

Ky standard i dyfishtë tregon se Serbia është trajtuar më butë se vendet e tjera. Nëse BE-ja do të kishte zbatuar të njëjtat rregulla si për Kroacinë ose Maqedoninë e Veriut, Serbia nuk do të kishte mundur të përfitonte kaq shumë nga marrëdhëniet me Perëndimin pa bërë lëshime thelbësore.

3. Raste konkrete të sabotimit serb ndaj Kosovës.

Serbia ka ndjekur strategji të ndryshme për të minuar sovranitetin e Kosovës. Më poshtë janë disa raste të rëndësishme që tregojnë se si Beogradi po punon aktivisht kundër Kosovës: 3.1. Destabilizimi i veriut të Kosovës.

Sulmi terrorist në Banjskë (2023): Në këtë rast, një grup i armatosur serb, i drejtuar nga Milan Radoičiq (nënkryetar i Listës Serbe), kreu një sulm terrorist kundër Policisë së Kosovës. Pas hetimeve u vërtetua se grupi kishte mbështetje direkte nga Beogradi.

Bllokimi i zgjedhjeve në komunat veriore: Serbia ka përdorur strukturat e saj ilegale për të penguar mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe demokratike në veri të Kosovës, duke nxitur bojkotin dhe destabilizimin e institucioneve vendore.

3.2. Fushata ndërkombëtare kundër njohjes së Kosovës. Serbia ka lobuar për tërheqjen e njohjeve të Kosovës nga vende si: Surinami (2017); Burundi (2018); Sierra Leone (2019); Gjineja-Bisau (2020).

Kjo strategji e koordinuar me Rusinë dhe Kinën ka ndikuar negativisht në avancimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare si OKB dhe Këshilli i Evropës.

4. Mekanizmat për ta kushtëzuar Serbinë me njohjen e Kosovës.

Bashkësia ndërkombëtare ka mjete të fuqishme për ta detyruar Serbinë të ndryshojë kursin. Disa nga masat më të efektshme përfshijnë: 1. Ndërprerja e fondeve të BE-së për Serbinë Serbia merr mbi 1 miliard euro ndihma nga BE-ja çdo vit, ndërkohë që punon kundër interesave evropiane. Këto fonde duhet të ndalohen derisa Serbia të njohë Kosovën. 2. Sanksione ekonomike dhe politike. Sanksionimi i zyrtarëve serbë të përfshirë në aktivitete destabilizuese (p.sh., Aleksandar Vulin, Milan Radoičiq)

Ndërprerja e investimeve evropiane në Serbi

3. Mbështetje më e madhe për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. ShBA dhe BE duhet të angazhohen fuqishëm për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës dhe NATO.

4. Politikë më e ashpër ndaj lidhjeve të Serbisë me Rusinë dhe Kinën. Serbia duhet të zgjedhë mes Perëndimit dhe aleancave të saj me Moskën dhe Pekinin.

Serbia nuk mund të vazhdojë të përfitojë nga Perëndimi duke punuar kundër tij. Kushtëzimi i saj me njohjen e Kosovës është një domosdoshmëri strategjike dhe gjeopolitike për stabilitetin e rajonit dhe të vetë BE-së.



Mbretëria e Bashkuar emëron diplomaten Karen Pierce të dërguar speciale për Ballkanin Perëndimor

PRISHTINË, 7 SHKURT - Mbretëria e Bashkuar ka emëruar Karen Pierce të dërguar speciale për Ballkanin Perëndimor. Në njoftim thuhet se një nga diplomatet më me përvojë të Mbretërisë së Bashkuar, Karen Pierce është emëruar për t'i çuar përpara objektivat strategjike të Mbretërisë së Bashkuar në të gjithë rajonin. "Me përvojën dhe ekspertizën e saj, Karen Pierce është personi ideal për ta çuar përpara këtë çështje të rëndësishme. Do të doja të

falënderoja Lord Peach për përkushtimin dhe shërbimin personal në avancimin e interesave të Mbretërisë së Bashkuar në Ballkanin Perëndimor gjatë tre viteve të fundit", ka thënë sekretari i Jashtëm i Britanisë, David Lammy.

Në njoftimin për medie bëhet me dije se Mbretëria e Bashkuar do të organizojë një samit me liderët e Ballkanit Perëndimor në vjeshtën e vitit 2025.

Në njoftim bëhet me dije se Samiti që do të mbahet në

vjeshtë dhe do ta nxisë bashkëpunimin me partnerët e Ballkanit Perëndimor për ta trajtuar migracionin e parregullt. "Mbretëria e Bashkuar do t'i presë krerët e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe udhëheqës të tjerë evropianë më vonë këtë vit për një Samit ndërkombëtar vendimtar për ta mbështetur stabilitetin, sigurinë dhe bashkëpunimin ekonomik në rajon", thuhet në njoftim.

Përpara se të shërbente si ambasadore britanike në



Shtetet e Bashkuara, Karen Pierce ishte përfaqësuese e përhershme e Mbretërisë së

Bashkuar në OKB. Ajo do ta marrë pozitën e re në pranverë.


Shenoll Muharremi: Sipas të gjitha gjasave, LV-ja do të përfundojë në opozitë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 7 SHKURT - Njohësi i çështjeve politike, Shenoll Muharremi, ka analizuar fushatën e Lëvizjes Vetëvendosje dhe kryetarit të kësaj partie, Albin Kurti. Muharremi ka shkruar në "Facebook" se pas datës 9 shkurt Lëvizja Vetëvendosje do të jetë parti opozitare. Ai ka thënë se duket që strategjia e fundit e LV-së rreth mobilizimit të elektoratit dhe maksimizimit të votës fokusohet në dy fusha: (a) Veri të Kosovës; dhe (b) Diasporë. "E keni parë sot agjendën e kryeministrit dhe postimet e partisë në veri, tek ura dhe prerja e shiritave atje. Me siguri që këto dy aspekte munden me qenë arma kryesore e Albin Kurtit. Në diasporë me siguri do t'i fitojë LV-ja shumicën e votave, rreth 51 %, ndërsa në Mitrovicë ka potencial me qenë komunë - përjashtim dhe i vetmi vend ku LV mirëmban më shumë vota se vendet e tjera nga baza e saj e 2021-s. Por të dyja këto nuk mjaftojnë për t'i rikuperuar tkurjen e përgjithshme në nivel vendi. Sidomos përkrahja ditët e fundit në Prizren, Pejë dhe Gjilan... komuna me shumë vota, munden me qenë sinjal që konfirmon tkurjen", ka thënë Muharremi.

Ai ka thënë se përkundër faktit që LV-ja mund t'i fitojë deri 85k vota nga diaspora (rreth 67k) dhe Mitrovicë (17k-20k),



ato nuk mjaftojnë për t'i arritur votat dhe përqindjen që synon për ta themeluar qeverinë me pakicat. "Kjo për shkak të strategjisë elektorale të LV-së 'O krejt, o asgjë' dhe

refuzimit për të bashkëpunuar me partitë e tjera", ka thënë ai. Ndërkaq në një shkrim të dytë në "Facebook", Muharremi ka theksuar se gjasat për një qeveri nga LV-ja pas 9 shkurtit

po shuhet. "Gjuha dhe pozicionet që po përdoren ditët e fundit duket sikur po e largojnë pushtetin dhe opozitën nga njëri-tjetri. Dikush mund të thotë që kjo

është një strategji elektorale në ditët e fundit të fushatës për ta mobilizuar sa më shumë elektoratin, por ka indikacione që kjo tashmë mund të jetë një fakt real", ka thënë ai, duke shtuar se gjuha e përdorur nga Albin Kurti i LV-së po eskalon kohën e fundit. "Ai nuk po lejon shumë hapësirë, me stilin dhe pozicionet e tij, për bashkëpunim. 'O krejt, o asgjë!', kjo është strategjia e tij. Kjo e komplikon tej mase situatën, sidomos pas 9 shkurtit. Nëse LDK-ja dhe LV-ja nuk kanë gjasë të bashkëpunojnë dhe nëse LV-ja mban pozicionin 'o krejt, o asgjë!', atëherë kjo nënkupton që janë disa parakushte tepër të vështira për LV-në për ta formuar qeverinë pas 9 shkurtit. LV-ja duhet të fitojë së paku 46 % të votave më 9 shkurt për të qenë në gjendje të krijojë një qeveri me pakicat, një qeveri me pak numra dhe aspak stabile. Por gjasat që LV-ja të marrë kaq shumë vota janë absolutisht minimale. As në teori e as në praktikë nuk shihet një rezultat i tillë. Kjo mund të nënkuptojë që LV-ja, me shumë gjasë, nuk do të jetë pjesë e qeverisë së ardhshme. Kjo për shkak se: nuk duket se do t'i fitojë 46 % të votave; LDK-ja nuk do të hyjë në koalicion me të; LV-ja nuk dëshiron një koalicion me ndonjë parti tjetër të opozitës. Prandaj, sipas të gjitha gjasave, LV-ja do të përfundojë në opozitë", ka shkruar Muharremi.

Përurohet nënstacioni policor në Leshak të Leposaviqit

PRISHTINË, 7 SHKURT - Kryeministri i vendit, Albin Kurti, ka përuar nënstacionin policor në Leshak të Leposaviqit. Kurti përmes një postimi në rrjetin social "Facebook" ka shkruar se prej tash ky nënstacion do të jetë burim i sigurisë dhe adresë e

raportimit për çdo qytetar pa dallim që jeton në këtë zonë. "Më 10 shtator 2024, para më pak se 5 muajsh, kemi vendosur gurthemelin e këtij nënstacioni policor këtu në Leshak të Leposaviqit. Sot ai është i gatshëm, dhe prej tash do të jetë burim i sigurisë dhe

adresë e raportimit për çdo qytetar pa dallim që jeton në këtë zonë. Pjesë e ndërtesës është edhe Agjencia për Regjistrim Civil, nga ku mund të marrin shërbimet qytetarë e komunës së Leposaviqit por edhe komunat e fshatrat përreth", ka shkruar Kurti.



“Trepça” rikthen nën menaxhim të gjitha pronat e veta

PRISHTINË, 7 SHKURT - Shoqëria Aksionare “Trepça” ka njoftuar se ka rimarrë nën menaxhim të gjitha pronat e saj. Certifikatat e pronësisë u dorëzuan në duart e kryeshefit ekzekutiv të Trepçës, Faton Ahmeti. “Një sfidë shumëvjeçare më në fund mori zgjidhje! Për dekada, pronat e Trepçës kanë qenë të shpërndara

nën 273 emërtime të ndryshme, duke e bërë të vështirë administrimin dhe zhvillimin e tyre pas luftës”, thuhet në njoftimin zyrtar të kompanisë. Ky rikthim rezultoi me bartjen nën pronësi të 2133 pronave, më saktë 12.6 kilometrash katrorë. “Për herë të parë pas luftës, po krijohet një regjistër i plotë dhe i detajuar për të gjitha pronat

në Kosovë. Ky është një hap thelbësor për transparencën dhe menaxhimin strategjik të pasurisë së Trepçës. Procesi do të vazhdojë edhe më tej për të përfshirë pronat e tjera që ende nuk janë regjistruar, duke siguruar një pasqyrë të qartë dhe të plotë të të gjitha aseteve të ndërmarrjes”, theksohet në njoftimin e “Trepçës”.



Eurostati: Shqipëria, vendi me dendësi më të ulët të hekurudhave në Evropë

TIRANË, 7 SHKURT - E gjithë Evropa ka krijuar ndërtesa të hekurudhave si një mjet më efikas për transportin e pasagjerëve të mallrave dhe me një ndikim më të ulët në mjedis. Edhe Bashkimi Evropian ka aktivitete të projektit të ndërtimit të hekurudhave. Në kontratë, Shqipërinë në 30 vitet e tranzicionit nuk e fokusojnë në sistemin e saj të hekurudhor, që trashëgohet nga e kaluara, apo në krijimin e lidhjeve të reja. Të dhënat e fundit të Eurostatit theksojnë se Shqipëria në vitin 2023 kishte vetëm 9 metra hekurudhë për 1 kilometër katror, më e ulët në Evropë. Në rajon, dendësia më e lartë e Serbisë me 44 metra për km katror, e ndjekur nga Maqedonia e Veriut (27.4), Kosova (22.8m), Mali i Zi (18.4m). Ndonëse me vonesë, së fundmi janë bërë hapa për ta rigjallëruar rrjetin hekurudhor. Hekurudha

Tiranë - Durrës, një financim i BERZh-it, po ndërtohet. Është hapur tenderi për vendosjen e hekurudhës Vorë - Hani Hotit. Hekurudha Rrogozhinë - Vlorë është në tenderimin e projektit të idesë. Hekurudha Prishtinë - Durrës është në fazën e projektimit. Është gati projekti, dhe është kërkuar financimi në BERZh-i për hekurudhën Durrës-Rrogozhinë. Sipas Eurostatit, në vitin 2023 rrjeti hekurudhor i BE-së kishte një gjatësi totale prej 200,947 km, me dendësinë më të lartë të linjave hekurudhore të përqendruara në qytetet kryesore dhe qendrat e tjera të popullsisë. Dendësia më e lartë e rrjetit hekurudhor u regjistrua në Çeki, me 123.2 metra linjë hekurudhore për km². Ndër vendet e tjera të BE-së me dendësi të lartë ishin Belgjika

(119.2 m/km²), Gjermania (109.5 m/km²) dhe Luksemburgu (104.8 m/km²). Në anën tjetër, dendësia më e ulët e rrjetit hekurudhor u regjistrua në Greqi (14.0 m/km²) dhe Finlandë (19.4 m/km²). Dendësi të ulëta u shënuan gjithashtu në Suedi (26.8 m/km²), Estoni (27.2 m/km²), Portugali (27.8 m/km²), Letoni (28.9 m/km²) dhe Irlandë (29.8 m/km²).

Zgjerimi i linjave hekurudhore, me shpejtësi të lartë në BE

Në rrjetin hekurudhor të BE-së linjat hekurudhore me shpejtësi të lartë, të projektuara për shpejtësinë mbi 250 km/h, shpesh kalojnë kufijtë kombëtarë, duke mundësuar udhëtime të pandërprera me shpejtësi të lartë brenda BE-së.



Ky rrjet i ndërlidhur ka përjetuar një rritje të ndjeshme gjatë dekadës së fundit. Nga viti 2013 deri në 2023, gjatësia e tij u zgjerua me 2,744 km (+47,2%), duke arritur në 8,556 km. Në vitin 2023 Spanja kryesoi me 3,190 km linja me shpejtësi të lartë, një rritje prej 66 % nga 1,919

km në vitin 2013, e ndjekur nga Franca me 2,748 km (+35 % nga 2,036 km), Gjermania me 1,163 km (+32 % nga 887 km) 675 km). Belgjika në përgjithësi 211 km me shpejtësi të lartë dhe Holanda 90 km (të pandryshuar nga viti 2013). Danimarka ka 57 km, të inauguruar në vitin 2019.

ZRRE-ja: Çdo deklaratë për rritjen e tarifave të energjisë elektrike aktualisht është e pavërtetë

PRISHTINË, 7 SHKURT - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka bërë me dije se ka pranuar aplikacionet nga operatorët e licencuar, në përputhje me kërkesat ligjore, për përshtatjet e të hyrave të lejuara maksimale dhe janë në proces të vlerësimit nga ZRRE por, sipas tyre, aktualisht çdo deklaratë ose informacion lidhur me rritjen e tarifave të energjisë elektrike në këtë moment është i pavërtetë

dhe ka për qëllim dezinformimin e opinionit publik. Në njoftimin për medie thuhet se këto aplikacione janë aktualisht në proces të vlerësimit nga ZRRE-ja dhe, pas përfundimit të këtij procesi, ZRRE-ja do ta publikojë raportin konsultativ, i cili do të ndahet me publikun për shqyrtim dhe komente. “Dëshirojmë të sqarojmë për



opinionin publik se çdo deklaratë ose informacion lidhur me rritjen e tarifave të

energjisë elektrike në këtë moment është i pavërtetë dhe ka për qëllim dezinformimin e opinionit publik. Këto pretendime nuk kanë asnjë lidhje me të dhënat aktuale të pranuar nga operatorët e licencuar dhe nuk pasqyrojnë procesin në vazhdim të vlerësimit nga ZRRE. ZRRE fton të gjitha palët e interesuara dhe qytetarët që për çdo pyetje, shqetësim ose informacion

lidhur me këtë proces, të kontaktojnë drejtpërdrejt me ZRRE për ta marrë informacionin e saktë dhe të bazuar në procedurat ligjore dhe rregullative të përcaktuara”, thuhet në njoftim. ZRRE-ja thekson se angazhimi i tyre është të sigurojnë një proces transparent dhe të drejtë, që u shërben interesave të qytetarëve dhe zhvillimit të sektorit të energjisë në përgjithësi.

BQE-ja miratoi vazhdimin e Linjës REPO deri më 2027, siguron nevojat e likuiditetit në Kosovë

PRISHTINË, 7 SHKURT - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka njoftuar se Këshilli Drejtues i Bankës Qendrore Evropiane (BQE) ka miratuar vazhdimin e Linjës REPO për BQK-në deri më 31 janar 2027. Kushtet e vazhimit të linjës së BQE janë pranuar nga BQK-ja me Letër Konfirmimin e datës 29 janar 2025, pas kërkesës së

BQK-së të datës 25 nëntor 2024 për vazhdim, dhe para skadimit të marrëveshjes së mëparshme. “Linja e përkohshme REPO në shumë maksimale prej 100 milionë euro, siguron një masë shtesë parandaluese për të adresuar nevojat e mundshme të likuiditetit dhe për të ruajtur stabilitetin e sistemit financiar të Kosovës. Megjithatë BQK

nuk e ka shfrytëzuar Linjën REPO të deritanishme, BQK e konsideron këtë instrument si shumë të rëndësishëm për stabilitetin monetar dhe financiar të Kosovës, veçanërisht marrë parasysh situatën aktuale të pasigurive globale dhe rreziqet e tyre potenciale për ekonominë botërore dhe tregjet financiare”, thuhet në njoftim.



Rrjetet sociale nuk kanë qenë kurrë neutrale. Ja si na skllavëruan



Andrea COLAMEDICI

Rrjetet sociale nuk kanë qenë kurrë neutrale. Ata kanë ndryshuar, pas çdo scroll-i, vetë mënyrën se si ne mendojmë për realitetin. Ky është teknofeudalizmi dixhital. Nuk është një distopi e të ardhmes. Është e tashmja, në të cilën jemi zhytur tashmë. Një sistem pushteti, i cili nuk kufizohet vetëm në kontrollin e informacionit, por plazmon edhe vetëdijen kolektive nëpërmjet arkitekturave teknologjike, që na i paraqesin si neutrale dhe të pashmangshme. Nuk është një shmangie nga sistemi, apo një zhvillim i papritur. Jo, është realizimi i

vet më i plotë.

Platformat sociale kanë vepruar gjithmonë sipas kësaj logjike. Prania në inaugurimin e Trumpit, e Elon Musk, Mark Zuckerberg si dhe tekno-oligarkëve të tjerë, është thjesht momenti kur pushteti del në skenë dhe fotografohet. Sepse ata nuk kanë më nevojë të fshihen prapa retorikës së neutralitetit teknologjik. Duhet pranuar, me një ndershmëri të pamëshirshme, se ne – mendimtarë, gazetarë, akademikë, analistë, e kemi pranuar këtë sistem sepse na ka ofruar një pushtet që e donim aq shumë: aftësinë për të përhapur idetë, për të plazmuar opinione, për të ndërtuar kollaj një publik përmes hapësirave të tyre.

Ishte një pakt faustian, dhe ne e dinim. Në këmbim të dukjes dhe influencës, ne mbyllëm një sy (ndonjëherë të dy), ndaj themeleve të brishta të ngrehinës. Artikulli pas artikulli, postimi pas postimi, kemi kontribuar për të legjitimuar atë sistem që me fjalë donim ta çmontonim. Teknofeudalizmi na transformoi, nga të nënshtruar të pavetëdijshëm në vasalë të vetëdijshëm. E kemi ditur gjithmonë që kjo arkitekturë kontrolli nuk është neutrale. Ajo është projektuar për të fragmentuar diskursin publik në fluska algoritmike, për të transformuar debatin në përplasje, për të reduktuar kompleksitetin e mendimit, në logjikën binare të like-ve.

Radikalizimi i diskursit publik nuk është një efekt anësor, por një karakteristikë strukturore, e qartë, e platformave të projektuara për të maksimizuar angazhimin përmes polarizimit. Dhe ajo që po jetojmë, nuk është aq shumë një krizë e demokracisë, se sa një transformim i thellë i sferës publike. Qytetaria dixhitale është një formë skllavërie e vullnetshme. Një nënshtrim që na paraqitet si zgjedhje, ku vetë pjesëmarrja i nënshtrohet logjikës së fitimit dhe kontrollit. Pranimi i këtij dimensionit është thelbësor për të imagjinuar forma të rezistencës, që shkojnë përtej kritikës sterile të pushtetit

teknokratik.

Alternativat teknike ekzistojnë tashmë: platforma të decentralizuara, protokolle open source, sisteme komunikimi autonome dhe të ndërlidhura. Por adoptimi i tyre i kufizuar zbulon se si problemi nuk është pikësëpari teknik. Pengesa e vërtetë është varësia psikologjike dhe sociale që kanë krijuar platformat dominuese. Prandaj rrugëdalja kërkon një lëvizje të dyfishtë: nga njëra anë, zhvillimin e infrastrukturave teknike alternative, që të mishërojnë parimet e autonomisë dhe kontrollit demokratik, dhe nga ana tjetër kultivimin e formave të reja të ekologjisë mendore. / bota.al



SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Montim
Servisim
Perdorim



Shqipëria dhe Serbia organizatore të U-21, Rama: Finalja do të mbahet në ‘Air Albania’

Pas zyrtarizmit nga UEFA-s me Shqipërinë e Serbinë që do të organizojnë së bashku “Euro 2027”, për U-21, ka reaguar

kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. Në një status në rrjetet sociale, kreu i qeverisë u shpreh se finalja e kampionatit

do të zhvillohet në arenën kuqezi të “Air Albania Stadium”. “Mirëmëngjesi dhe me Shqipërinë e përzgjedhur

nga UEFA, si një nga dy vendet organizatore të Kampionatit Evropian U-21 në qershor të vitit 2027, por që do ta

mikpresë finalen në arenën kuqezi të ‘Air Albania Stadium’, ju uroj një ditë të mbarë!”, ka shkruar Rama.

Drita dhe Ballkani e nisin sezonin pranveror me fitore



“Epoka e re”

PRISHTINË, 7 SHKURT - Skuadra e Dritës ka shënuar fitore ndaj Malishevës (2-0) në ndeshjen e parë të sezonit pranveror të Superligës së Kosovës në futboll. Gjilanasit konfirmuan se janë kandidatë seriozë në garën për titull. Pjesa e parë e ndeshjes përfundoi me rezultat 0-0. Në pjesën e dytë vendasit u treguan skuadër më e mirë dhe arritën të shënojnë dy gola për të marrë tri pikë të mëdha. Mbrojtësi Besnik Krasniqi, i cili në minutën e 61-të shënoi për epërsinë 1-0, ndërsa në minutën e 78 ishte i saktë për rezultatin final 2-0. Pas kësaj fitore, Drita zë vendin e parë me 43 pikë, ndërsa Malisheva renditet e treta me 30 pikë. Në ndeshjen tjetër skuadra e

Ballkanit ka arritur fitore të vështirë ndaj Dukagjinit me rezultat 1-0, në ndeshjen e vlefshme për javën e 19 në Superligën e Kosovës. Kampionët në fuqi të elitës shënuan një gol në minutat shtesë për t'i marrë pikët e plota. Si në pjesën e parë ashtu edhe në të dytën, Ballkani ishte skuadër më e mirë, por goli i vetëm në këtë ndeshje erdhi në minutën e pestë shtesë me anë të Sunday Adetunji, i cili shënoi me kokë për rezultatin përfundimtar 1-0. Ballkani pas kësaj fitore renditet në pozitën e dytë me 36 pikë, ndërsa Dukagjini renditet i shtati me 21 pikë. Sot (e shtunë) zhvillohen dy ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje, ku Prishtina e pret Suharekën dhe Llapi e pret Gjilanin. Sezonin vjeshtor Prishtina e mbylli në vendin e

katërt dhe do të mundohet që sezonin pranveror ta fillojë me fitore, kurse suahrekasit që përfunduan një pozitë më poshtë, në kryeqytet udhëtojnë për rezultat pozitiv. Ndërsa në stadiumin “Zahir Pajaziti”, Llapi që e pati një sezon dëshpërues në vjeshtë, synon ta nisë me fitore sezonin në përballje me Gjilanin. Skuadra e Tahir Batatinës është e parafundit në tabelë me vetëm 18 pikë, në anën tjetër gjilanasit janë të gjashtit me 21 pikë.

SUPERLIGA

Ballkani - Dukagjini
Drita - Malisheva

1-0
2-0

Të shtunën takohen:
Llapi - Gjilani
Prishtina - Suhareka

Të hënën takohen:
Ferizaj - Feronikeli 74

SHKURT

Përforcohen Bashkimi dhe Trepça

KB Bashkimi ka nënshkruar me basketbollistin Au'Diese Toney. Ky i fundit ka përvojë edhe në një ligë të fortë evropiane dhe Champions League. “Jemi të lumtur të njoftojmë se Au'Diese Toney është lojtari më i ri i KB Bashkimi! Në sezonin e fundit ai ishte pjesë e Kolossos H Hotels Rodou në Greqi (GBL), duke sjellë përvojë të vlefshme nga një ligë e fortë evropiane dhe Champions League”, thuhet në njoftimin e klubit prizrenas. Edhe KB Trepça është përforcuar. Klubi mitrovicas ka njoftuar se lojtari më i ri është amerikan Michael Green, të cilin edhe e ka paraqitur të premten në rrjetet sociale. 24-vjeçari Green luan në pozitën e fundorit dhe vjen nga kampionati i Maqedonisë së Veriut, duke u paraqitur për Tikveshin. Amerikani ishte ndër koshashënuesit më të mirë të ligës me mesatare prej 25,1 pikësh për ndeshje, 2,7 kërcime dhe 5,3 asistime për lojë.

Policia gjermane largon banerat e tifozëve serbë që paraqisnin Kosovën pjesë të Serbisë

Të enjten në mbrëmje gjatë ndeshjes mes Alba Berlinit dhe Crvena Zvezdas në Euro League ndodhi një incident në mes të Policisë së Gjermanisë dhe tifozëve nga Serbia. Tifozët serbë kishin shpalosur disa flamuj që paraqisnin Kosovën pjesë të Serbisë. Reagimi i Policisë së Berlinit ishte i menjëhershëm, duke i detyruar tifozët serbë t'i hiqnin.

Kumbulla: Jemi të motivuar, duam suksesin ndaj Sociedadit

Marash Kumbulla kërkon që Espanyoli të vijojë me rezultate pozitive, pasi në katër ndeshjet e fundit në kampionat ka dy fitore dhe dy barazime. Suksesi i javës së kaluar me Real Madridin në shtëpi është një motiv krenarie, por tani vëmendja është në përballjen me Real Sociedadin. “Mendoj që do të jenë më të motivuar. Zakonisht një skuadër e tillë nuk humbet ndeshje pa fund, kështu që do të jetë më e vështirë pasi do të kërkojnë fitoren, por ne do të bëjmë gjithçka për t'i marrë tri pikët”, ka thënë Kumbulla. Mbrojtësi kuqezi pranoi se të gjithë lojtarët po punojnë shumë për të qenë gati të dielën në mbrëmje. Objektivi i këtij sezoni për Espanyolin është qëndrimi në La Liga.

Shaqiri: Duhet të qëndrojmë me këmbë në tokë dhe të punojmë shumë

Basel, 7 shkurt - Baseli fitoi me vështirësi ndaj Luzernit (2-1), ndeshje e cila i takoi xhiros së 22-të të elitës së futbollit të Zvicrës. Sfidu u vendos nga dy penallti për të cilat u fol shumë, por të cilat u realizuan për mrekulli nga Xherdan Shaqiri. Pas 34 sekondave lojë, Baseli ishte në disavantazh 1:0, por golat nga Shaqiri në minutën e

katërt dhe të 57 ia siguruan pikët e plota Baselit. “Mendoj se e kemi merituar fitoren. Luajtën dy ekipe shumë të mira. Luzerni, po ashtu, i dëshironte pikët e plota, por në fund ne fituam me meritë. Më së shumti jam krenar për fitoren. Në fund të fundit është gjëja më e rëndësishme në futboll”, ka deklaruar Shaqiri. Por, titullin e 21-të

të Baselit kapiteni i skuadrës e sheh ende larg. “Ka qenë e rëndësishme të krijojmë një bazë. Tani jemi në krye të tabelës dhe kemi pak pikë më shumë ndaj skuadrave të tjera. Kjo na jep motivim për ndeshjet e ardhshme, por kemi shumë ndeshje para. Duhet të qëndrojmë me këmbë në tokë dhe të punojmë shumë”, ka shtuar Shaqiri.



Ronaldo nderon Marcelon: Karrierë e pabesueshme, më shumë sesa një shok ekipi për mua

MADRID, 7 SHKURT - Në moshën 36-vjeçare Marcelo Vieira da Silva Junior, ose më thjesht Marcelo, vendosi t'i varë këpucët dhe t'i thotë lamtumirë futbollit të luajtur. "Historia ime si lojtar përfundon këtu, por kam ende shumë për t'i dhënë futbollit. Faleminderit shumë!", ka komentuar mbrojtësi i majtë

brazilian në videon prekëse të publikuar në rrjetet sociale. Shumë sportistë dhe ish-shokët e skuadrës, si dhe Real Madridi (i përmendur shumë herë nga Marcelo në video) komentuan lajmin, duke i transmetuar ngrohtësi lojtarit dhe nuk hezituan t'i kushtojnë fjalë të ëmbla dhe falënderime për atë që i ka dhënë botës së

futbollit. Nuk mund të mungonte as Cristiano Ronaldo, me të cilin ka pasur gjithmonë një lidhje të veçantë, të lindur në kohët e lavdishme të kaluara së bashku në Casa Blanca. "Vëllai im, çfarë karriere e pabesueshme! Kemi jetuar shumë bashkë, kanë qenë vite pushtimesh, fitoresh dhe

momentesh të paharrueshme. Më shumë se një shok ekipi, një shoqëruar për jetën time. Faleminderit për gjithçka, mik! Të uroj gjithë të mirat në këtë fazë të re të jetës!", ishte mesazhi i CR7-shit. Së bashku ata kanë ngritur katër Liga të Kampionëve (2014, 2016, 2017 dhe 2018), tri Kupa të Botës për Klube, tri Superkupa



UEFA, dy La Liga, dy Kupa të Mbretit dhe dy Superkupa të Spanjës.

Ferhan Hasani i jep fund karrierës

TETOVË, 7 SHKURT - Futbollisti ikonë Ferhan Hasani ka shpallur tërheqjen nga futbollit aktiv në moshën 34-vjeçare, duke lënë pas një karrierë të jashtëzakonshme, të nisur e të mbyllur te Shkëndija e Tetovës. Lajmin e ka bërë dhënë vetë Hasani përmes një videoje emocionuese në rrjetet sociale, ku ndau kujtimet më të bukura të karrierës së tij dhe falënderoi të gjitha klubet ku ka luajtur. I formuar te Shkëndija, ai ishte pjesë e skuadrës që në vitin 2011 kur edhe fitoi titullin e parë kampion në histori të klubit. Më pas, talenti i tij u shpërblye me një karrierë ndërkombëtare, duke luajtur për ekipe si Wolfsburg (Gjermani), Brøndby (Danimarkë), Al Raed (Arabia Saudite), Helsinki (Finlandë), Partizani (Shqipëri) dhe Helsingør (Danimarkë). Periudha më e artë e tij ishte mes viteve 2015-2018, kur si kapiten i Shkëndijës udhëhoqi ekipin drejt titullit kampion dhe Kupës së vendit, duke e bërë skuadrën më dominante



në Evropë me një diferencë rekord prej +35 pikësh. Ai gjithashtu ishte pjesë e suksesit historik të klubit në garat evropiane, duke u përballur me ekipe të mëdha, përfshirë AC Milanin. Përveç suksesit me klubet, Hasani la gjurmë edhe në arenën ndërkombëtare, duke qenë pjesë e përfaqësueses së Maqedonisë së Veriut dhe

duke kontribuar në kualifikimin historik për Euro 2021. Nga një talent i akademisë së Shkëndijës i cili më pas u shndërrua në një figurë ikonike të futbollit shqiptar, Ferhan Hasani mbetet një legjendë e paharrueshme. Magjia e tij me topin dhe lidhshipi do të kujtohen gjithmonë nga tifozët kuqezi.

LeBroni fiton duelin me Curryn, kampionët e Bostonit dorëzohen në shtëpi



LOS ANXHELOS, 7 SHKURT - Kampionët e Bostonit zhgënjyen në fushën e tyre, ku u mundën 127-120 nga Dallasi. Vendimtar stoli i ekipit teksan, nga erdhën 57

pikë, ndërkohë që Klay Thompson me 25 pikë ishte lider për miqtë. Fitoi skuadra e Lakersit, që mundi 120-112 Golden Staten. Tjetër ndeshje

REZULTATET

Boston - Dallas	120-127
Minnesota - Houston	127-114
Denver - Orlando	112-90
Lakers - Golden State	120-112
Portland - Sacramento	108-102
Clippers - Indiana	119-112

magjike për LeBron Jamesin, që realizoi 42 pikë e 17 rebounde, duke i bërë të pavlefshme 37 pikët e Stephen Curryt për Warriorsin. Ekipi i Minnesotas, falë 41 pikëve të Anthony Edwardsit, mundi 127-114 Houstonin, ndërsa Clippersi triumfoi 119-112 ndaj Indianas, ndeshje ku u dallua kolektiviteti i ekipit kalifornian (6 lojtarë realizuan mbi 12 pikë).

SHKURT

UEFA po shqyrton heqjen e vazhdimeve në Ligën e Kampionëve

UEFA po e shqyrton mundësinë e heqjes së vazhdimeve në ndeshjet me eliminim direkt të Ligës së Kampionëve duke filluar nga viti 2027, raporton "The Guardian". Kjo do të thotë që, nëse një ndeshje përfundon në barazim pas 90 minutave, ajo mund të shkojë direkt në penallti pa luajtur 30 minutat e zakonshme të dy vazhdimeve me nga 15 minuta. UEFA mendon se koha shtesë shpesh nuk është shumë efektive, pasi ekipet luajnë më të kujdesshme dhe ndonjëherë synojnë vetëm penalltitë. Lojtarët janë të lodhur pas 90 minutash, dhe 30 minuta shtesë rrisin rrezikun e lëndimeve. Një ndryshim i tillë mund ta bëjë garën më emocionuese dhe ta rrisë intensitetin e lojës.

Real është i hapur për shitjen e Viniciusit

Një klub nga Arabia Saudite thuhet se i ka ofruar Vinicius Juniorit një kontratë pesëvjeçare me vlerë 1 miliard euro. Sipas "RMC Sport", nëse Vinicius Jr pranon, Real Madridi do ta konsideronte shitjen e tij për një tarifë transferimi rekord botëror. Gazetari Fabrice Hawkins raportoi se nëse Vinicius vendos të largohet, Real Madridi do të ishte i hapur për ta shitur atë. Braziliani ende nuk i është përgjigjur ofertës. Pavarësisht prej lëndimeve dhe fillimit të vështirë të sezonit, Real Madridi mbetet i fokusuar në të ardhmen. Presidenti Florentino Perez dhe ekipi i tij tashmë po planifikojnë për sezonin e ardhshëm. Vinicius ka qenë një lojtar kyç për Real Madridin, por paraqitjet e tij kanë tërhequr kritika në Spanjë.

109 gola në 35 ndeshje, Flick: Kemi një skuadër të uritur

Hansi Flick ka analizuar fitoren 5-0 në Mestalla, e cila i lejoi katalanasit të kualifikoheshin në gjysmëfinalen e Kupës së Mbretit. "Një sukses shumë i rëndësishëm për ne. Jam i lumtur me ekipin. Krijua rastë dhe shënuam gola herët dhe kjo na lejoi të shënonim më shumë", ka thënë Flick. 109 gola në 35 ndeshje: "Është një shifër mbresëlënëse. Dhe lojtarët kanë ruajtur motivimin e tyre, gjë që tregon urinë që ka ekipi. Lojtarët ishin të fokusuar në përpjekjen për të shënuar më shumë gola". Flick ka folur edhe për portierin Szczesny: "Unë mendoj se detyra e tij është ta mbrojë portën dhe na jep stabilitet. Ai përsëri mbajti portën e pastër dhe kjo është ajo që ka rëndësi".

Van Dijk: Ende nuk e di të ardhmen time

Mbrojtësi holandez Virgil Van Dijk u shpreh edhe një herë se nuk ka asnjë ide në lidhje për të ardhmen e tij te Liverpooli. Ai u shpreh se nuk është marrë ende asnjë vendim.

Kapiteni i "Reds", i cili shënoi golin e fundit të skuadrës së tij në "Anfield" në këtë ndeshje, i skadon kontrata në verë dhe mund të largohet me koston zero. Ai mund të flasë

me çdo klub jashtë Anglisë për një marrëveshje paraprake. "Nuk e kam ende idenë se çfarë do të sjellë e ardhmja. Kushdo që thotë se e di të ardhmen time, ju

garantoj se e ka gabim. Nuk ka asnjë të re as në lidhje me qëndrimin tim te Liverpooli", ka thënë Van Dijk. Mediet thanë se 33-vjeçari kishte rënë dakord për një

marrëveshje të re për të qëndruar në "Anfield", por Van Dijk i hodhi poshtë këto sugjerime. Ndërkohë që ai kërkohet edhe në Arabinë Saudite.



- Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- [illegible]



SWISS TAVERNA

PRISHTINË

We inform all customers that the limited liability “ZemZem Pizza” L.L.C. with headquarters Ferizaj, with owner Orhan Elezi and Agron Isufi has come to the decision to quit its business: 811591694 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly requested to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



 Mbrapa Teatr-it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

